

*Prof. Dr. Muin ÇAMI*

## DOMOSDOSH MËRIA E LUFTËS SE VLORËS<sup>1</sup>

Lufta e Vlorës është rrahur shumë në historiografi. Megjithatë vëzhgimi i ngjarjeve historike nga kënde të ndryshme, sidomos i atyre madhore, si p.sh. Lufta e Vlorës, mbetet pothuajse pa fund. Këtu përfshihet edhe trajtimi i rrethanave që e bënë të domosdoshme shpërthimin e Luftës së armatosur të Vlorës, temë që m'u duk me interes për ta trajtuar në këtë tubim, kushtuar 85-vjetorit të Luftës çlirimtare të Vlorës.

Duhet venë në dukje se lufta e zhvilluar në krahinën e Vlorës kundër forcave pushtuese italiane është ndeshja e parë e armatosur që forcat atdhetare shqiptare kanë organizuar kundër njësisive ushtarake të një Fuqie të Madhe evropianoperëndimore në harkun kohor prej gati gjysmë shekulli. D.m.th. që nga Lidhja e Prizrenit e deri pak vite pas mbarimit të Luftës I Botërore, në qershor të vitit 1920. Lufta e 1920-ës ka pra një parahistori, njohja e së cilës, në formë qoftë panoramike, ndihmon për të kuptuar rrethanat që e bënë të domosdoshme shpërthimin e Luftës së Vlorës.

Kjo luftë u organizua dhe shpërtheu pasi trupat italiane kishin gati 6 vjet që ishin vendosur në Vlorë. Njësi të forcave të armatosura italiane kaluan Adriatikut pak muaj pas shpërthimit të Luftës I Botërore, në dhjetor 1914, dhe u vendosën në fillim në qytetin e Vlorës dhe në rrethinat e afërta të tij, të cilësuar si "Gjibraltari i Adriatikut". Në vitet që pasuan, më 1915 dhe në vitin 1916, italianët e zgjeruan zonën e pushtimit mbi të gjithë krahinën e Vlorës dhe atë të Gjirokastrës.

Po gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918, mbi pjesë të tjera të truallit të shtetit shqiptar u shtrinë edhe forca të armatosura të dy Fuqive të Mëdha evropiane. Këto ishin forca të Perandorisë Austro-Hungareze të cilat më 1916 u vendosën në territoret që nga Veriu i vendit e deri në lumin Vjosë.

---

<sup>1</sup> Trajtesë përgatitur dhe lexuar fillimisht në sesionin e organizuar në Vlorë më 6 qershor 2005 nga Prefektura e qarkut të Vlorës. Këshilli i qarkut dhe Bashkia e Vlorës. Sesionin i mbait me rastin e 85-vjetorit të Luftës së Vlorës.

Po në vitin 1916 njësi të armatosura të ushtrisë franceze kaluan kufijtë e Shqipërisë juglindore dhe zunë vend në krahinën e Korçës.

Megjithëse kishim të bënim me forca të huaja që shkelnin vendin, shqiptarët nuk organizuan ndonjë qëndresë të armatosur kundër këtyre forcave as në kohën e depërtimit të tyre në trojet shqiptare, dhe as më vonë, kur zunë vend dhe qëndruan në këto territore për disa vite. Ky qëndrim shpjegohet me faktin se populli shqiptar gjatë viteve të Luftës I Botërore jetonte më shumë me rrezikun që i vinte vendit nga synimet ekspansioniste të monarkive ballkanike fqinje, çka ndikonte për t'i parë perëndimorët si një lloj mburoje nga ky rrezik. Madje rrethet atdhetare në Korçë arritën deri atje sa në dhjetor 1916 të nënshkruanin me komandën e njësitit francez të atjeshëm edhe një protokoll bashkëpunimi me interes të ndërsjellë, protokoll ky mjaft i njohur tanimë në histori. Në fakt njësitë e armatosura franceze dhe ato italiane u vendosën në dy trevat e Shqipërisë së Jugut pasi përzunë prej andej garnizonet ushtarake greke. Po ashtu trupat austro-hungareze u shtrinë në Shqipërinë e Veriut dhe në të Mesmen duke u zënë aty vendin njësisive të ushtrisë serbe dhe malazeze.

Mungesa e organizimit të një qëndrese të armatosur lidhet edhe me një faktor tjetër politik. Forcat e huaja që u vendosën në territoret e shtetit shqiptar bënë pjesë në dy blloqet e Fuqive të Mëdha veropiane ndërluftuese. Franca me Italinë ishin pjesëtare të bllokut të Antantës, ndërsa Austro-Hungaria bënte pjesë në bllokun e Fuqive qendrore. Fuqitë e këtij blloku nuk kishin nënshkruar ndonjë traktat për të ardhmen e Shqipërisë pas luftës, sikurse kishin vepruar Fuqitë e Antantës më 26 prill 1915, kur nënshkruan me Italinë atë që ka hyrë në histori me emrin Traktat i Fshehtë i Londrës. Megjithatë edhe Austro-Hungaria, që rivalizonte me Italinë për sundim në Shqipëri, nuk mendonte që në mbarim të Luftës të ripërtëritej pavarësia e Shqipërisë dhe të ruhej tërësia territoriale e shtetit shqiptar, që ishin kërkesat bazë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Të vënë përpara këtyre pozitave politike të vështira, shqiptarët jo vetëm nuk bënë ndonjë rezistencë ndaj forcave evropianoperëndimore që kaluan kufijtë dhe u vendosën në Shqipëri por as edhe armët e tyre nuk i bashkuan (me ndonjë përjashtim), me ato të asnjërit prej të dy blloqeve në luftë. Duke iu përshtatur rrethanave, forcat politike shqiptare parapëlqyen të qëndronin në pozitat e asnjësisë dhe të prisnin më mirë mbarimin e luftës botërore për të mbrojtur kështu më lirshëm të drejtat e tyre kombëtare. Kështu lufta e vërtetë e popullit shqiptar dhe e udhëheqësve të tij filloi atëherë kur mbaroi Lufta I Botërore dhe u zhvillua kundër forcave ushtarake të Italisë, që ishte njëra prej Fuqive të Mëdha fituese të kësaj lufte.

Organizimi dhe zhvillimi i Luftës kundër forcave italiane u bë i domosdoshëm pas një viti e gjysmë nga mbarimi i luftës botërore dhe kur

shteruan të tëra përpjekjet e anës shqiptare për sheshimin e konfliktit për të ardhmen e Vlorës me mjete politike dhe pra atëherë, kur përdorimi i armës mbeti mjete i fundit.

Lufta e Parë Botërore mbaroi më 11 nëntor 1918 me fitoren e Fuqive të Antantës. Atëherë forcat e armatosura italiane arritën të shtriheshin në pjesën më të madhe të Shqipërisë.<sup>2</sup> Kjo rrethanë shpuri në atë që forcat politike shqiptare të kishin të bënin më shumë me autoritetet italiane të pushtimit dhe që midis tyre të dilnin në shesh fërkime për probleme të ndryshme, prej të cilave disa arritën të sheshoheshin, herë pas here, por jo ai për të ardhmen politike të krahinës së Vlorës.

P.sh. italianët, deshën s'deshën, e pranuan vendimin e Kongresit të Durrësit të dhjetorit 1918 për ngritjen e një qeverie shqiptare në vend të një komiteti, me të drejta të kufizuara, të propozuar prej tyre. Në muajt e fundit të vitit 1919 miratuan edhe përfshirjen e krahinës së Gjirokastrës nën juridiksionin e kësaj qeverie, që nuk e kishin lejuar më parë. Për modalitetet e kalimit të Prefekturës së Gjirokastrës nga vartësia e Komandës italiane të pushtimit nën vartësinë administrative të qeverisë shqiptare, u nënshkrua bile edhe një protokoll. Ky ishte një veprim politik që synonte të neutralizonte jehonën tronditëse që ngjalli në opinionin publik shqiptar nënshkrimi i marrëveshjes italo-greke të korrikut 1919, ajo Tittoni-Venizelos për ndarjen e Shqipërisë. Pak më vonë, pasi dështuan në përpjekjet e tyre për të penguar mbajtjen e Kongresit të Lushnjës të janarit 1920, italianët pranuan më në fund të hynin në kontakte me qeverinë që doli nga ky kongres, me shpresë se do të arrinin edhe nënshkrimin e kësaj qeverie, siç kishte ndodhur me Qeverinë e Durrësit, të rrëzuar nga Kongresi i Lushnjës.

Nga ky kongres doli edhe Këshilli Kombëtar, siç u quajt atëherë Parlamenti, dhe që nisi nga puna dy muaj përpara fillimit të Luftës së Vlorës, në fund të marsit 1920. Autoritetet italiane nuk guxuan të ndërhynin për shpërndarjen me forcë të këtij institucioni dhe as për të penguar punimet e tij.

Të ndodhur përballë Lëvizjes Kombëtare që u rrit dukshën pas janarit 1920, italianët kaluan më shumë në pozita mbrojtëse. Ata i tërhoqën forcat e tyre të armatosura nga brendësia e territorit shqiptar duke i dislokuar përgjatë bregdetit, më shumë në krahinën e Vlorës, si masë për të përballuar

---

<sup>2</sup> Trupat italiane nuk u shtrinë dot vetëm në krahinën e Korçës, ku vazhduan të qëndronin njësitë e ushtrisë franceze; po ashtu në qytetin e Shkodrës, i cili në mbarim të Luftës u vendos nën administrimin e një garnizoni ushtarak ndërkombëtar, i përbërë nga trupa të Fuqive të Mëdha evropiane, fituese të Luftës: të Francës, Italisë dhe Britanisë së Madhe. Trupat e armatosura italiane u shtrinë edhe në veri të vendit, me përjashtim të disa zonave në verilindje, ku hynë më parë trupa të ushtrisë serbe.

ndonjë veprim të mundshëm kundër tyre. Kështu gjeneralët italianë, sidomos politikanët, nuk donin të hiqnin dorë nga zotërimi i pozitës gjeostrategjike detare të Vlorës.

Ndërhyrjet e shumta të anës shqiptare, si të qeveritarëve të mëparshëm të Durrësit ashtu edhe ato më të guximshme të Qeverisë së Lushnjës, për zgjidhjen e konfliktit për të ardhmen e Vlorës me mjete politike, ndeshën në kundërshtimin e prerë të palës italiane. Për italianët kalimi i krahinës së Vlorës nën sovranitetin e Italisë ishte tanimë vendosur e vulosur dhe kjo e ardhme nuk mund të vihej në diskutim.

Për të mos lëvizur nga këmbëngulja e tyre, përfaqësuesit e rretheve ekspansioniste të Gadishullit Apenin sajuan argumente gjithfarëshe. Për ta ishin shqiptarët ata që duhej të hiqnin dorë nga kundërshtimi i sovranitetit italian mbi krahinën e Vlorës jo vetëm se kjo "zgjidhje" ishte miratuar nga përfaqësuesit e të gjitha Fuqive të Mëdha fituese të Luftës Botërore, evropiane dhe jashtë Evropës, por edhe për një arsye tjetër. Kur vendet fqinje ballkanike të Shqipërisë kishin aneksuar më parë, në vitet 1912-1913, pjesë të trojeve shqiptare, Kosovën dhe Çamërinë, nuk mund t'i refuzohej tani, sipas tyre, fqinjtit të përtej detit që të merrte edhe ky një pjesë nga këto troje. "Pra, fati i Vlorës duhet konsideruar në të njëjtën mënyrë me atë të krahinave që më parë i janë aneksuar Serbise dhe Greqisë", shkruante shefi i diplomacisë italiane në fund të prillit 1920.<sup>3</sup>

Në të njëjtën kohë fqinjët ballkanikë, edhe këta fitues të Luftës Botërore, kërkonin pjesë nga tokat e shtetit shqiptar, Jugun dhe Veriun, nëse tërësia tokësore e këtij shteti do të shkelej në favor të Italisë, me shikëputjen e Vlorës prej tij. Mbi këtë bazë i kishte shtruar pretendimet në Konferencën e Paqes në Paris diplomacia e Athinës dhe edhe më prerë ajo e Beogradit, kur rivalizonin me diplomacinë e Romës për të ardhmen e Shqipërisë, më sakt për copëtimin e saj.

Kështu, pas dështimit të përpjekjeve për zgjidhjen e konfliktit për Vlorën me mjete politike, populli shqiptar dhe udhëheqësit e tij u vunë përpara alternativës: ose të pranonin nënshtrimin ose të vendosnin kundërshtimin me mjete të tjera. Këto rrethana shpunë domosdoshmërisht te përdorimi i armëve si mjeti i fundit që u kishte mbetur shqiptarëve. Nënshtrimi do të shpinte jo vetëm në shikëputjen nga trungu i shtetit shqiptar i krahinës së Vlorës, porse kjo shikëputje vinte në rrezik edhe dy krahinat e Shqipërisë së Jugut, veçanërisht atë të Gjirokastrës. Nuk ishte jashtë rrezikut as Shqipëria e Veriut. Ky rrezik ekzistonte pavarësisht se gjendja politike e

<sup>3</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirimim kombëtar 1918-1920* (Përmbledhje dokumentesh), II, Tiranë, 1976, dok. 198, f.246.

këtyre krahinave në prag të Luftës së Vlorës kishte ndryshuar për mirë në krahasim me gjendjen e tyre në mbarim të Luftës Botërore.

Me largimin, në mars 1920, të garnizonit ndërkombëtar nga Shkodra, ky qytet me rrethinat e tij u bashkua me pjesën tjetër të vendit dhe kaloi nën administrimin e qeverisë shqiptare të Tiranës. Në prill, me tërheqjen e forcave italiane nga brendësia e territorit të shtetit shqiptar, edhe krahina e Gjirokastrës kishte kaluar nën kontrollin administrativ të organeve të qeverisë shqiptare. Po kështu edhe krahina e Korçës. Vendin e njërive ushtarake franceze, që u larguan prej andej në fund të majit 1920, nuk e zunë dot forcat greke, sikundër tentuan. Edhe këtu gjendjen e shtinë në dorë qarqet atdhetare të krahinës, të pasuara nga njësitë ushtarake dhe institucionet civile të Qeverisë së Tiranës.

Përfshirja e këtyre krahinave nën administrimin e Qeverisë Kombëtare të Tiranës ishte një arritje me peshë e kësaj qeverie dhe e të gjitha forcave atdhetare. Mirëpo këto suksese të brendshme ishin të *pjesëshme* meqë krahina e Vlorës vijonte të mbetej gjithnjë, për shkak të kundërshtimit të qeveritarëve italianë, jashtë juridiksionit administrativ të kësaj qeverie. Madje arritjet ishin të *përkohshme* ngase asgjë pozitive nuk kishte lëvizur në këtë ndërkohë, nga janari në qershor, për Shqipërinë nga pikëpamja ndërkombëtare.

Gjendja e jashtme e vendit në fillim të qershorit 1920 ishte po ajo e gjashtë muajve më parë, pra e kohës së Kongresit të Lushnjës. Përfaqësuesit e tri Fuqive kryesore fituese të luftës kishin diskutuar rreth të ardhmes së Shkodrës dhe rrethinave, nëse kjo do t'i kalonte Jugosllavisë, sikundër mendonin kryeministrat e Francës dhe të Britanisë së Madhe, apo do të mbetej në kufijtë e shtetit shqiptar, siç kërkonte presidenti amerikan Vudro Uilson (Woodrow Wilson). Për të ardhmen e pjesëve të tjera të shtetit shqiptar dhe për statusin politik të tij, asgjë nuk kishte lëvizur.

Dokumenti kryesor i hartuar për Shqipërinë nga përfaqësuesit e këtyre tri Fuqive ishte memorandumi i tyre i përbashkët i 9 dhjetorit 1919, përmbajtjen e të cilit shpërthimi i Luftës së Vlorës e gjeti të paprekur nga autorët e tij. Sipas këtij memorandumi, Jugosllavisë i njihej e drejta e një daljeje tregtare në Shqipërinë e Veriut; Vlora me krahinën do të kalonin nën sovranitetin e plotë të Italisë; Greqia mund të pushtonte trevën e Gjirokastrës, çka do të ishte një hap drejt aneksimit, kurse e ardhmja e Korçës (nëse edhe kjo krahinë do t'i kalonte Greqisë apo do të mbetej në kufijtë e shtetit shqiptar) do të përcaktohej në diskutimet e ardhshme. Më në fund, Shteti shqiptar, i cunguar territorialisht, do të vihej nën mandatin e Italisë, duke humbur kështu pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar. Vënie në jetë të këtij memorandumi u rekomandonte Presidenti i SHBA partnerëve të tij të Francës dhe Britanisë së Madhe, kur në shkurt-mars 1920 refuzoi të

pranonte kompromisin e tyre me kryeministrin e Italisë të janarit 1920, që i jepte Shkodrën dhe rrethinat Jugosllavisë në shkëmbim me Fiumen (Rijekën), që do t'i kalonte Italisë.<sup>4</sup>

Kjo ishte gjendja e jashtme e Shqipërisë në prag të Luftës së Vlorës. Kjo gjendje si dhe pozita kyçe që zinte e ardhmja politike e Vlorës për të ardhmen e problemit mbarëkombëtar, ishin të njohura nga drejtuesit e politikës shqiptare të kohës, si nga anëtarët e Qeverisë së Lushnjës ashtu edhe nga ata të Parlamentit. Këtë koniunkturë politike ndërkombëtare e kishte parasysh kryeministri Sulejman Delvina, kur më 21 prill 1920 deklaronte në sallën e Parlamentit se i vetmi mjet shpëtimi që kishte mbetur ishte ai që t'i tregohej botës se "jemi të gjallë, të zotët, e se meritojmë për vetësundim".<sup>5</sup>

Zëvendësimi i luftës politike me luftë të armatosur ishte një akt shumë i guximshëm, me shumë të panjohura, por u bë i domosdoshëm. U bë e pashmangshme edhe pse kishte shumë dilema rreth asaj se cili do të ishte zhvillimi dhe sidomos mbarimi i kësaj lufte, do të mbaronte me fitore apo me humbje? E kush mund të bënte se do të arrihej mrekullia, kur një numër fshatarësh që do të ngrinin dyfekët "e lidhur me gjalmë", do të arrinin deri atje sa të mposhtnin njësitë e një ushtrie të rregullt e të armatosur me mjete luftarake moderne të kohës !?. Ka madje historianë apo politikanë shqiptarë si Tajar Zavalani, i cili përdorimin e armëve në këto kushte e ka cilësuar si "kulmi i marrëzisë dhe një vetëvrasje kolektive e sigurt."<sup>6</sup> Dyshimin në përfundimin e luftimeve e shprehte edhe Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare të Vlorës", në ultimatumit që i dërgoi gjeneral Piaçentinit më 3 qershor 1920, në të cilin theksohej se: "Nuk jemi aspak të pakuptuar që një popull i vogël si i Shqipërisë të mund ta bindë me fuqi të armës një qeveri si të Italisë kaq të madhe. Po qeveria italiane, sado e madhe që është, nuk mundet kurrë ta ndalojë popullin e vogël të Shqipërisë të vdesë për idealin e lirisë së tij".<sup>7</sup>

Po ashtu askush nuk mund të parashikonte atë që ndodhi në Itali në fillim të luftës dhe gjatë saj, kur në mbështetje të kësaj lufte të drejtë nacionalçlirimtare u organizuan nëpër shumë qytete të Gadishullit Apenin manifestime të fuqishme të punonjësve italianë, që i thanë ndal dërgimit të forcave të reja ushtarake nga Italia për të luftuar në Vlorë.

<sup>4</sup> Për këtë shih: *Historia e Shqipërisë*, vëllimi i tretë, 1912-1944, Tiranë, 1984, f. 197, dhe f. 214-215. Botim i Institutit të Historisë. Shih edhe: A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës I Botërore*. vëll III. (1919-1926), Tiranë, "Albin", 2001, f. 41-43, 228-231, 225-227.

<sup>5</sup> Bisedimet e Këshillit Kombëtar, viti 1920, f. 29.

<sup>6</sup> T. Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, Phoenix, 1998, f. 261.

<sup>7</sup> *Lufta e popullit...*, II, dok. 280, f. 324.

Domosdoshmëria e përdorimit të armëve shkoi deri atje sa u gjet edhe mënyra për të shpëtuar nga pasojat nëse përplasjet me armë do të mbaronin pa sukses për forcat çlirimtare shqiptare. Përpara kësaj të panjohure luftës me armë iu dha karakteri i një lufte jo midis të dy vendeve fqinje, Italisë e Shqipërisë, d.m.th. midis dy shteteve, por i një lufte të banorëve të krahinës që kërkonin largimin e të huajve nga vendi i tyre. Se kush e ka hedhur këtë mendim, individ apo institucion, në Tiranë apo në Vlorë, për këtë nuk kemi ndeshur në të dhëna dokumentare të kohës. Mund të thuhet vetëm se në prag të fillimit të luftimeve, dy përfaqësuesit e Vlorës në Parlamentin e Tiranës, Qazim Koculi dhe Spiro Gogo Koleka, lanë Tiranën dhe erdhën këtu në Vlorë, ku u radhitën midis drejtuesve të luftës.

Lufta çlirimtare e Vlorës për fat të mirë mbaroi ashtu siç nuk pritej nga shumëkush. Mbaroi me fitoren e armëve shqiptare dhe me shpëtimin e vendit nga e keqja e madhe që e priste. Në Luftën e Vlorën morën pjesë vullnetarë nga shumë krahina të vendit, porse për fitoren e kësaj lufte kontribuan, në radhë të parë, qarqet patriotike të Vlorës dhe të krahinës së saj. Atyre u ka takuar dhe u takon nderi dhe lavdia e fitores.

*Prof. Dr. Muin ÇAMI*

## NECESSITY OF VLORA WAR

### Summary

Liberation War of Vlora fortunately ended the way it was expected by many. It ended with victorious Albanian arms and rescue of the nation from the evil.

In the Vlora War were engaged volunteers from many of the country's provinces and its own province.

The glory of victory and the honour belongs to them.

